

Prison Radio

International
Sound &
Radio Art
Festival

10-13

Shtator

Programi

PRISON x ARCHIPELAGO

17:00

Opening / Hapja:

Burgu i Idealit

Swiss Embassy Prishtina
Austrian Embassy Prishtina
PRISON RADIO Team
Hava Shala & Martin Çuni

- Concert / Koncerti
Ilir Bajri (KS)

live broadcasted / e transmetuar live on Lumpen
Station (CH)

PRISON x NIGHTS

19:00

- Kolektiv Radio (KS)
Listening & Music Session /
Sesion dëgjimi & muzikë

Live from / Live nga
Hani i dy Robertëve

with / me Agona & Somer

PRISON x HANI

19:00

- Lumpen Station (CH)

Live from / Live nga
Hani i dy Robertëve

10.09.26

PRISON x EXERCISE

- Uta Ibrahim (KS) & Eva Buzo (AU/UK)

"I am out with lanterns, looking for myself" /

"Endem me fenerë duke kërkuar vetveten"

7K Poetical Community Run /
7K vrapim kolektiv poetik

09:00-10:00

Meeting Point / Vendtakimi:

Gërmia Park: Bus Stop /
Parku i Gërmisë:
Stacioni i autobusit

Registration / Regjistrimi
info@stralli.org

or personally in /
ose personalisht në:
Burgun e Idealit

**Limited places /
Vende të kufizuara**

PRISON x COMMUNITY

- Sarah Washington (UK/DE) & Knut Aufermann (DE)
- Masterclass
Mobile Radio: 20 years of Radio as Art /
Mobile Radio: 20 vite të radios si art

10:30-12:00

Burgu i Idealit

Registration / Regjistrimi
info@stralli.org

or personally in /
ose personalisht në:
Burgun e Idealit

**Limited places /
Vende të kufizuara**

11.09.26

PRISON x RADIO LIVE

12:00 - 16:00

- Lumpen Station (CH)
Live from / Live nga
Burgu i Idealit
-

Burgu i Idealit

PRISON x SURVEILLANCE

15:00

- Maja Zećo (BiH/UK)
Live Performance / Performancë live

Defend and Protect /
Odbrana i Zaštita / Mbrojtje dhe Ruajtje
-

Burgu i Idealit

PRISON x NOISE

16:00

- Labinot Kelmendi (KS)
Lecture / Ligjëratë

Noisology: Noise as mirror of society /
Zhurmhuri: Zhurma si pasqyrë e shoqërisë
-

Burgu i Idealit

PRISON x RESISTANCE

17:00

- Eli Krasniqi (KS/AT)
Lecture / Ligjëratë

Gendered Histories of Resistance and
Imprisonment /
Histori të rezistencës dhe burgosjes nga
perspektiva gjinore

Burgu i Idealit

11.09.26

PRISON x TRANSMISSION

18:00

- Tonic Train feat.
HAM Radio Orchestra Kosova
(Sarah Washington, Knut Aufermann, HAM Radio
Association Kosova)
 - Concert / Koncert
-

Burgu i Idealit

PRISON x NIGHTS

19:00

- Kolektiv Radio (KS)
Listening & Music Session /
Sesion dëgjimi & muzike
- With an / me
Open Jam Session
-

Live from / Live nga
Hani i dy Robertëve

PRISON x HANI

19:00

- Lumpen Station (CH)

Live from / Live nga
Hani i dy Robertëve

11.09.26

PRISON x RESISTANCE

10:30-12:00

- Eli Krasniqi (KS/AT)
Masterclass

Archives in Suspension: Temporalities
of the Resistance Movement in Kosova / Arkiva në
pezullim: Kohështrirjet e
Lëvizjes së Rezistencës në Kosovë

Burgu i Idealit

Registration / Regjistrimi
info@stralli.org

or personally in /
ose personalisht në:
Burgun e Idealit

**Limited places /
Vende të kufizuara**

PRISON x RADIO LIVE

12:00-16:00

- Lumpen Station (CH)
Live from / Live nga
Burgu i Idealit

Burgu i Idealit

PRISON x FREQUENCY

15:00

- Anouk Albrecht (DE)
Live Performance / Performancë live

Episode 6, an ongoing nomadic
performance piece /
Episodi 6, seri performancash
nomade të vazhdueshme

Burgu i Idealit

12.09.26

PRISON x LITERATURE

16:00

- Elsa Demo (AL)
Live Radio Essay / Ese radiofonike Live

Burgu i Idealit

From the Silence of Words /
Prej heshtjes së fjalëve

PRISON x GARDEN

17:00

- Orgest Azizi (AL / FR)
Lecture / Ligjëratë

Burgu i Idealit

Drowned Voices, Wild Grass /
Zëra të mbytur, bar i egër

PRISON x BODY

18.00

- Adina Camhy (AT)
Concert / Koncert

Burgu i Idealit

PRISON x NIGHTS

19:00

- Kolektiv Radio (KS)
Listening & Music Session /
Sesion dëgjimi & muzike

Live from / Live nga
Hani i dy Robertëve

with / me
Toni Dimitrov (MKD) performing
Listening backward & Ygretmen (KS)

PRISON x HANI

19:00

- Lumpen Station (CH)

Live from / Live nga
Hani i dy Robertëve

12.09.26

PRISON x SCHOOL

10:00-11:30

- Maja Zećo (BiH/UK)
with / me Blertë Ismajli (KS)
& Verena Walzl (AT)

Soundwalk / Shëtitje dëgjimore
Retracing Steps / Rigjurmimi i hapave

Meeting Point / Vendtakimi:
Përmendorja
Bajram Kelmendi (Dragodan)

Registration / Regjistrimi
info@stralli.org

or personally in /
ose personalisht në:
Burgun e Idealit

**Limited places /
Vende të kufizuara**

PRISON x LISTENING

11:30-12:00

- Knut Aufermann (DE)

Guided Listening Tour /
Closing Performance /
Shetitje dëgjimore e orientuar /
Performancë përmbyllëse

Remnants & seeds /
mbetje & fara

Burgu i Idealit

PRISON x RADIO LIVE

11:00-13:30

- Lumpen Station (CH)
Live from / Live nga
Burgu i Idealit

Burgu i Idealit

Closing Event / Mbyllja e Festivalit

13.09.26

Fjalë Hyrëse - Prison Radio

Burgu zakonisht përfytyrohet përmes mbylljes, mureve dhe grilave. Por çdo burg ka edhe anën e vet sonore; zërat, britmat, hapat, trokitjet, këngët që i japin formë përditshmërisë brenda një arkitekture të caktuar. Këtë aspekt dëgjimor e hasim edhe në shumë prej memoareve të ish-të burgosurve politikë të Kosovës, në rrëfimet e tyre nga Burgu i Prishtinës, por edhe në burgje të tjera gjatë periudhës së Jugosllavisë socialiste. Çfarë mund të zbulojmë, përmes kësaj perspektive dëgjimore, nga këto kujtime që nuk kapen a të shihen aq lehtë?

Në vitin 2015, *Kulturkonsorten*, një iniciativë eksperimentale-ndërmjetësuese që operonte kryesisht online, i ftoi disa muze në Gjermani që në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Muzeve, “t’i bënëin muzetë të jehonin”, me një fjalë, t’i “zgjonin” përmes instalimeve të tingullit [sound] apo t’ua thyenin heshtjen, atë atmosferë të kujdesshme që zakonisht i shoqëron vizitorët në raport me njëritjetrin gjatë vëzhgimit të ekspozitave muzeale apo veprave të artit. Kjo nismë hapi diskutime të reja mbi mënyrën e përfshirjes së tingullit në muze dhe objekteve kulturore-historike. Edhe PRISON RADIO në Kosovë nisi të shtjellonte e të diskutonte mbi instalimet e tilla në hapësira ku zëri kryesisht inkorporohej si formë dominimi nga jashtë, apo mbi mënyrën se si ai transmetohet herë pas here si sfond nëpër shumë ekspozita në rajon. Kështu, PRISON RADIO filloi të mendojë edhe mbi mënyrën se si hapësira të tilla mund të lexohen, kujtohen dhe të rivendosen para publikut.

Muzeu i Burgut të Idealit, përveç aspektit historik që bartë dhunën e historitë e burgosjes politike, bartë edhe arkivin e zërave dhe trupave, që kanë vazhduar të jehojnë prej dekadash mbi rezistencën dhe praktikën e mbijetesës. Në një intervistë, Hava Shala kujton qysh në izolim iu desh të këndonte në vazhdimësi, sidomos gjatë periudhave të vështira kur trupi përballej me kufijtë e dhimbjes dhe mendja rrezikohej drejt çmendisë. Kënga e recitimi i poezive u bënë praktika të qëndrueshmërisë. Në kushtet e izolimit, kur pothuajse gjithçka kontrollohej nga mekanizmat e burgut, zëri mbetej prej pak hapësirave nga ku mund të prodhohej ende nga vetëm një trup. Hava thotë se “Askund ma bukur kënga nuk tingëllon sesa në burg.” Kënga u bë kështu një mënyrë për ta rimarrë, qoftë përkohësisht, hapësirën që burgu ia merrte trupit. Në rrëfimin e Ibish Idrizit, në burgun e Staragradishkës, shfaqet një formë tjetër e kësaj çarjeje. Të burgosurit krijuan fshehurazi një radio nga materiale të zakonshme: një kuti kartoni, kapakë pastash dhëmbësh dhe komponentë të improvizuar. Natën, me kokën nën batanije dhe kufje në vesh, dëgjonin Tiranën, radiot lokale dhe Zërin e Amerikës. Lajmet si burim informacioni kalonin pastaj nga një i burgosur te tjetri. Si objekt, radioja ishte e ndaluar, por në këtë rast kryente një funksion përtej atij teknik duke krijuar një kanal komunikimi me botën që burgu përpiqej ta kufizonte.

PRISON RADIO në bashkëpunim me partnerët, për katër ditë synon ta transformojë hapësirën e muzeut në një

instrument transmetimi publik e hapësirë sociale dëgjimore, prej së cilit në formë kolektive mund të dëgjojen zëra nga arkivi, koncerte, ligjërata, intervista live, punëtori, performanca, biseda e shumë aktivitete të tjera përreth muzeut "Burgu i Idealit" si shëtitje dëgjimore apo vrapim poetik komunitar. Këto aktivitete sajojnë një radio që lëviz mes burgut dhe hapësirave publike, mes së kaluarës, së tashmes, trupit e teknologjisë. Festivali në këtë format, siç do të thoshte Alexander Kluge, e shndërron radion nga një medium modern i komunikimit nga distanca, në një medium "më të drejtpërdrejtë të publikes klasike". Duke hyrë në një hapësirë historikisht të ndërtuar e planifikuar për izolim, mediumi radio i "ngjason" tashmë më shumë shfaqjeve operistike apo teatrore nga rrafshi i drejtpërdrejtshmërisë klasike.

Gjatë ditëve të festivalit, edhe ekspozita *Sound, Resisting* e trajton kundërthënien e arkitekturës së burgut, duke u nisur nga tensioni mes kontrollit dhe tingullit i cili i sfidon kufijtë dhe dëgjohet përtej tyre. Një bosht tjetër i festivalit është programi radiofonik 72-orësh që i shndërron Burgun e Idealit dhe Hanin e dy Robertëve në transmetues dhe marrës. Ish të burgosurit politikë mund të takohen me studiues, artistë, muzikantë dhe krijues radiofonik nga Kosova dhe vendet tjera. Programi nis me audio-materiale e regjistrime nga Kosova, për t'u hapur më tej drejt përvojave të tjera të burgimit nga Shqipëria, Kolumbia, Kameruni, Siria, Gjermania dhe kontekste të tjera. Përmes Lumpenstation, transmetimi shtrihet për 72 orë, ndërsa Kolektiv Radio nga Studio Hani në Hani i dy Robertëve vazhdon me sesione të dëgjimit dhe muzikës, duke e "zhvendosur" radion

nga hapësira historike e burgimit drejt një hapësirë alternative sociale.

Krahas ekspozitës dhe programit radiofonik, festivali përfshinë koncerte, performanca, ligjërata, masterklasa dhe forma kolektive dëgjimore mobile. Koncerti i hapjes i Ilir Bajrit nisë si eksperimentim mes gjuhës dhe ritmit nga libri tashmë klasik *Disiplinë dhe ndëshkim* e Michel Foucault-së. Tonic Train dhe HAM Radio Orchestra Kosova sajojnë një koncert specifik në shëtitoren e burgut, duke sjellë nga eteri sinjale, interferenca e zëra. Adina Camhy ndërthur elektronikën, zërin dhe regjistrimet në terren nga Burgu i Prishtinës, ndërsa Toni Dimitrov, me *Listening Backward*, e trajton tingullin si arkiv të vendeve dhe momenteve që kanë ndryshuar ose janë zhdukur.

Performancat e vendosin trupin në marrëdhënie me kufizimin, mbikëqyrjen dhe transmetimin. Në *Defend and Protect / Odbrana i Zaštita / Mbrojtje dhe Ruajtje*, Maja Zeço mbart mbi trup një jelek të rënduar, që transmeton tinguj të dronëve ushtarakë, duke sjellë përvojën e kërcënimit në nivel trupor. Në *Episode 6*, Anouk Albrecht punon me mikrofoni radiofonik të brishtë, ku lidhja krijohet, humbet dhe rikthehet; dështimi i transmetimit bëhet pjesë e vetë performancës. Në mbylljen e festivalit, Knut Aufermann me *mbetje & fara*, e kthen dëgjimin në veprim kolektiv përmes një shëtitjeje dëgjimore nëpër kompleksin e burgut.

Ligjëratat dhe format eseistike e hapin festivalin ndaj filozofisë, historisë, letërsisë dhe kërkimit shkencor. Labinot Kelmendi me ligjërata të *Zhurmhuria: Zhurma si pasqyrë e shoqërisë* shqyrton zhurmën si pasqyrë dhe mundësi transformimi shoqëror. Eli Krasniqi përmes historive gojore, këngës e ditarëve, i

rikthen përvojat e grave ish të burgosura politike përgjatë rezistencës në Kosovë. Elsa Demo, në *Nga Heshtja e Fjalëve*, pyet për mbijetesën e letërsisë nën diktaturën shqiptare, ndërsa Orgest Azizi, në *Zëra të mbytur, bar i egër*, e zhvendos vëmendjen nga burgu si hapësirë optike të zhurmat, mërmërimat, britmat dhe zërat që ai mban.

Masterklasët reflektojnë drejt shkëmbimit dhe punës së përbashkët. Sarah Washington dhe Knut Aufermann sjellin përvojën e *Mobile Radio* dhe radion si praktikë artistike të lidhur me vendin dhe transmetimin, ndërsa Eli Krasniqi, në *Archives in Suspension*, punon me arkivin e fragmentuar të “Illegales” për të shtruar pyetje se si fshehtësia, burgimi dhe qasja e vonuar ndikojnë në njohjen dhe shkrimin e historisë.

Në Parkun e Gërmisë, Uta Ibrahim dhe Eva Buzo na shoqërojnë përmes vrapimit poetik komunitar *7K Endem me fenerë duke kërkuar vetveten*, ku shëtitja krijon hapësirë për të biseduar mbi qendrueshmërinë dhe kufijtë e trupit. Me *Retracing Steps*, Maja Zeço, Blertë Ismajli dhe Verena Walz e zhvendosin dëgjimin nëpër Prishtinë, duke rigjurmuar rrugën e Blertës drejt shkollës gjatë viteve të 1990-a, të ashtuquajturin “sistemi paralel” në Kosovë.

PRISON RADIO për katër ditë synon të na shpie drejt një rrafshi të publikes klasike, ku një trup përkohësisht ndodhet mes njerëzve dhe transmetimit valor, në një kohë e vend të rënduar kujtese. Aq më tepër kur ai vend, i projektuar për ndarje dhe dhunë, prodhon tashmë një situatë vitale publike, ku dëgjimi bëhet një akt i të qenit bashkë dhe i rezistencës. Rezistenca si një reflektim kritik mbi burgosjen mes së kaluarës, së tashmes dhe së ardhmes; krijimi i një hapësire për kapërcimin e mureve politike, kulturore dhe të brendshme, si dhe bashkimi si praktikë politike për të krijuar rezistencën.

Prison × Exhibition - Sound, Resisting

"Zëri yt përthyeret fare pranë meje, dashuri." June Jordan

Burgu nuk është thjesht një arkë. Arkitektura e tij prodhon një rend hapësinor të dukshmërisë, të afërsisë dhe të distancës. Muret ndajnë trupa, qelitë i individualizojnë ata, dyert i kushtëzojnë lëvizjet, korridoret e përcaktojnë qarkullimin, ndërsa kulla e vërojimit e strukturon vështrimin. Arkitektura është operative: ajo i përcakton vendosjet e trupave dhe marrëdhënieve njerëzore, po ashtu pozicionet, i ndërpret kontaktet dhe prodhon forma të së dukshmes dhe të padukshmes. Megjithatë, ky rend hapësinor ngel i paqëndrueshëm në planin akustik. Tingulli depërton përmes mureve, tubacioneve, dyerve dhe korridoreve, dhe vendos marrëdhënie ndërmjet hapësirave dhe trupave që arkitektura është projektuar për t'i mbajtur të ndara.

Sound, Resisting, është njëra prej ekspozitave në festivalin PRISON RADIO, që merr si pikënisje këtë kontraditë. Nisur nga arkitektura dhe historia specifike e ish-Burgut të Prishtinës, sot i njohur si Muzeu Burgu i Idealit, ekspozita gjurmon mënyrën se si izolimi dhe mbyllja veprojnë përmes marrëdhënieve ndërmjet trupave, hapësirave, zërave dhe imazheve.

Instalacioni sonor i Adina Camhyt, *so that we'd never feel alone*, i krijuar posaçërisht për këtë vend e hapësirë, trajton sinjalet e trokitjeve përmes të cilave dikur të burgosurit politikë komuniknin përtej mureve dhe tubacioneve të radiatorëve. Arkitektura e ndarjes u përvetësua

si infrastrukturë komunikimi: muri ngeli pengesë për trupin, mirëpo u shndërrua në bartës të tingullit. Në kullën e vërojimit, vepra *Different Light* e Sarah Washington përqendrohet tek historia e Abdullah Zhegrovës dhe Akile Dedinca Zhegrovës, një çift që e bashkoi historia e aktivizmit dhe burgimit. Struktura e projektuar për të organizuar vështrimin, pushtohet tashmë nga zëra që rikthejnë intimitetin dhe dashurinë në një hapësirë të formësuar nga vëzhgimi dhe ndarja.

Kësisoj, tingulli bëhet i dukshëm gjatë gjithë ekspozitës, jo si material artistik, por si marrëdhënie hapësinore dhe shoqërore. Ai depërton, jehon, kapërcen kufij dhe krijon forma afërsie pa e zhdukur distancën fizike. *Pros and Cons*, nga Lucy Cathcart Frödén dhe Áine Mangaoang, në bashkëpunim me InHouse Harmony, fokusohet te një kor "sa brenda - aq jashtë" në burgun Mountjoy në Dublin, duke e shtrirë këtë marrëdhënie përtej qelisë: të burgosurit dhe të burgosurat, si dhe ata jashtë burgut marrin pjesë në një strukturë të përbashkët sonore, veçse mbeten të ndarë institucionalisht. Dallimi ndërmjet së brendshmes dhe së jashtmes vazhdon të ekzistojë, por bëhet i përshkueshëm në planin akustik. *Jail Time Records* e sjell këtë marrëdhënie drejtpërdrejt brenda burgut. E themeluar në New Bell Central Prison në Douala të Kamerunit, kjo shtëpi diskografike prodhon dhe lanson muzikë të krijuar nga artistë të burgosur dhe ish-të burgosur: pra tingulli që është krijuar përgjatë izolimit, udhëton tashmë përtej mureve të tij.

PRISON X LOVE, kuruar nga Ekipi Kuratorial i PRISON RADIO, e zhvendos këtë problem drejt intimitetit. Një projektion diapozitivësh me motele në Kosovë bashkojnë ekonomi të ndryshme të afërsisë, fshehtësisë, dëshirës dhe ndarjes. Intimiteti këtu nuk qëndron në kundërshtim me izolimin. Edhe ai varet nga organizimi hapësinor: nga ajo se kush e ka mundësinë e takimit, ku mund të takohen trupat dhe në çfarë kushtesh bëhet e mundur afërsia, e ndaluar apo e fshehur.

Në një pikë tjetër, shprehja artistike bëhet vetë objekt rregullatori. *Befas u zgjove... / You suddenly woke up...* e Thomas Krempkes merr si pikënisje një poezi të shkruar nga Visar Zhiti në burgun e Spaçit në vitin 1982. Në një tjetër qeli, lexohen me zë shkrime nga proza e shkurtër e Adem Demaçit, duke rikthyer në këtë arkitekturë zërin e njërit prej të burgosurve politikë më të shquar të Kosovës. Dy litografi të Maks Velos bëhen pjesë e ekspozitës përmes një historie tjetër të persekutimit dhe censurës artistike në Shqipëri. Një playlist e përgatitur nga Elsa Demo, e përbërë nga këngë të edicionit të 11-të të Festivalit të Këngës të vitit 1972, sjell në kujtesë represionin politik që pasoi festivalin, kur artistët dhe punonjësit e kulturës u persekutuan, u larguan nga jeta artistike ose u burgosën. Tingulli këtu nuk depërton më vetëm përmes strukturave të izolimit; por ai vetë i nënshtrohet një renditjeje ideologjike. Çfarë mund të këndohet, dëgjohet, përfaqësohet apo transmetohet bëhet çështje politike.

Me *Celda B-8 ¼*, Juan Camilo Herrera Casilimas dhe Andrés Arizmendy Benavides e sjellin *PRISON x SOCIAL THINKING* në një tjetër qeli, përmes

historisë së sociologut kolumbian Miguel Ángel Beltrán. Zhvendosja gjeografike është e qëllimshme: jo për të vendosur një barasvlerësim ndërmjet historive të ndryshme të burgimit, por për të shqyrtuar mënyrën se si akuza, burgosja dhe stigmatizimi mund të funksionojnë si teknika përmes të cilave rendet politike dhe shoqërore riprodhohen vetveten.

PRISON X ANIMAL, kuruar nga Ekipi Kuratorial i PRISON RADIO, e zgjeron këtë konstalacion drejt kafshës dhe trupit të stërvitur. Kafazi, përsëritja, imitimi dhe disiplina nxjerrin në pah një tjetër marrëdhënie midis izolimit dhe formimit: subjekti nuk kufizohet vetëm nga kufijtë, por prodhohet përmes praktikave të stërvitjes, përshtatjes dhe përsëritjes. Premtimi i lirisë mbetet i ndërthurur me mekanizmat përmes të cilëve formësohen trupat dhe sjelljet. Ish-portieri i futbollit Oliver Kahn lexon dhe interpreton poezin *Pantera* të Rilkes, duke e “vendosur” kafshën në kafaz në marrëdhënie me disiplinën dhe trupin e stërvitur.

Në shëtitoren e vogël të burgut, *Dalja nga Terri / Out of the Dark* e Hazir Rekës e zgjeron ekspozitën nga qelia drejt pragut të lirit. Përmes fotografisë së shtypur në format të madh, Reka na sjellë Veton Surroin duke dalë nga Ish-Burgu i Prishtinës në vitin 1991. Vetë fotografia është realizuar fshehurazi, përmes dritares së një makine, në një kohë kur fotografimi i burgut ishte i ndaluar.

Pra, *Sound, Resisting* manifestohet përmes afërsisë dhe bashkëvendosjes, jo përmes barasvlerësisë: qelia pranë qelisë, muri pranë murit, hapësirat e brendshme, oborri dhe kulla e vrojtimi. Burgimi politik, censura, intimiteti, solidariteti, prodhimi artistik dhe disiplina

trupore mbeten historikisht të dallueshme. Megjithatë, vendosja e tyre përkrah njëra-tjetrës i bën të lexueshme disa operatione përsëritëse: ndarja dhe lidhja, e dukshmja dhe e fshehura, përsëritja dhe rregullimi, zëri dhe ndërprerja e tij.

Burgu si histori specifike funksionon këtu si arkitekturë e përqendruar, brenda së cilës mekanizmat që në jetën shoqërore janë të shpërndarë, bëhen materialisht më të dukshëm. Përtej qelisë, këta mekanizma nuk zhduken aq lehtë; ata ndryshojnë formë. Muret bëhen më pak të dukshme, disiplina brendësohet, ndërsa afërsia rregullohet pa grila. Tingulli, zëri, imazhet, intimiteti dhe solidariteti nuk i kapërcejnë lehtë këto struktura, por e ekspozojnë paqëndrueshmërinë: pikën në të cilën një rend i projektuar për të ndarë - prodhon kundër vetvetes forma të reja marrëdhënieje.

Prison X Radio - Programi I Radios

*Ndoshta universi ishte krijuar në heshtje.
Nuk e dimë.*

R. Murray Schafer,
The Soundscape (1977)

Radioja ka qenë gjithmonë më shumë sesa teknologji transmetimi dhe radiodifuzioni. Në formën e saj më të fuqishme, ajo është një praktikë komunitare: njerëzit flasin, dëgjojnë njëri-tjetrin, prodhojnë, shkëmbejnë, kujtojnë dhe krijojnë gjëra së bashku. Për festivalin PRISON RADIO, ky dimension shoqëror është thelbësor. Programi radiofonik krijon një hapësirë të përkohshme kolektive, ku përvojat dhe njohuritë mbi burgimin, izolimin, mbikëqyrjen dhe rezistencën mund të kapërcejnë muret fizike të Ish-Burgut të Prishtinës dhe të ngrenë pyetje rreth mënyrës se si burgimi shndërrohet në forma shoqërore të izolimit dhe kufizimit.

Programi nis në Kosovë dhe me njerëz, njohuritë e të cilëve burojnë drejtpërdrejt nga këto histori. Ish-të burgosurit politikë dhe personat me përvoja burgimi takohen me studiues, artistë, muzikantë dhe krijues radiofonikë vendas, të cilët trajtojnë çështje të burgimit, kujtesës dhe rezistencës. Kontributet e tyre marrin formën e bisedave, intervistave, regjistrimeve, leximeve, ligjëratave, ndërhyrjeve sonore, muzikës dhe artit radiofonik.

Ish-Burgu i Prishtinës është një vend ku historitë e dhunës dhe izolimit mbeten të pranishme si materialisht, ashtu edhe në mënyrë jomateriale. Hapësira të tilla ndodhen në një gjendje ndërmjetësie, ku e kaluara nuk është zhdukur thjesht,

por vazhdon të jehojë në të tashmen. Kjo mund të krijojë një formë liminaliteti të përhershëm, në të cilën historitë mbeten të ngulitura në arkitekturë, trupa, kujtime dhe në jetën e përditshme. Prandaj, burgun nuk trajtohet si një objekt historik i mbyllur, por si një prag midis brendësisë dhe jashtësisë, së kaluarës dhe së tashmes, heshtjes dhe asaj që mund të dëgjohet.

Radioja vepron drejtpërdrejt brenda kësaj gjendjeje liminale. Arkitektura e burgut synon ndarjen dhe izolimin, megjithatë tingulli gjithmonë i ka ndërlikuar këta kufij. Zërat përshkojnë muret, dyert dhe korridoret, e këngët dhe trokitjet shndërrohen në forma komunikimi, tingujt nga jashtë depërtojnë në qeli, ndërsa kujtimet dhe rrëfimet dalin përmes letrave, dëshmimeve dhe fragmenteve të kujtesës. Radioja e zgjeron edhe më tej këtë përshkueshmëri. Transmetimi e shndërron burgun nga një strukturë e projektuar për të kufizuar lëvizjen dhe komunikimin në një hapësirë transmetimi.

Për 72 orë, festivali PRISON RADIO do të transmetojë përmes Lumpenstation (CH), platformës së pavarur zvicerane të radios dhe artit sonor, të themeluar dhe drejtuar nga Mathilde dhe Andrea Marioni. Që nga viti 2019, Lumpenstation ka zhvilluar një praktikë radiofonike të bazuar në takime të drejtpërdrejta, eksperimentim kolektiv, infrastruktura të pavarura transmetimi dhe përfshirjen e zërave të ndryshëm, duke vepruar si në hapësira të pavarura kulturore, ashtu edhe në kontekste institucionale. Transmetimi 72-orësh krijon një hapësirë radiofonike të pandërprerë rreth festivalit, duke e shtrirë atë

që ndodh në Prishtinë larg përtej mureve të burgut dhe duke e bërë programin të qasshëm për dëgjuesit në vende të tjera.

Në kuadër të këtij transmetimi, çdo ditë do të transmetohen drejtpërdrejt 12 orë nga ish-Burgu i Prishtinës dhe nga Hani i dy Robertëve. Lëvizja ndërmjet këtyre dy hapësirave është një pjesë e rëndësishme e programit: nga një ish-vend burgimi në një nga hapësirat afatgjatë shoqërore dhe kulturore në Prishtinë. Radioja i lidh ato në një hapësirë të përkohshme akustike, duke u mundësuar bisedave, performancave, tingujve dhe publikut të lëvizin ndërmjet izolimit dhe qytetit.

Kolektiv Radio nga Prizreni/ Kosovë, përbën platformën kryesore vendore që e lidh festivalin PRISON RADIO me artistë radiofonikë, performues, muzikantë dhe veprimtarë të pavarur kulturorë në Kosovë. Roli i tij nuk kufizohet vetëm në transmetim apo bashkëpunim teknik, por përfshin edhe krijimin e marrëdhënieve: sjelljen në program të rrjeteve ekzistuese vendore, praktikave dhe kulturave muzikore, si dhe lidhjen e pjesëmarrësve ndërkombëtarë me komunitetin e radios dhe artit sonor në Kosovë. Së bashku me festivalin PRISON RADIO, Kolektiv Radio do të organizojë gjithashtu sesione të dëgjimit live në Hanin e dy Robertëve, duke krijuar një hapësirë ku dëgjimi bëhet kolektiv dhe jo privat: njerëzit mbledhen rreth veprave radiofonike, muzikës, regjistrimeve dhe bisedave, dhe reagojnë ndaj tyre së bashku.

Tingulli është veçanërisht i përshtatshëm për këtë punë, sepse lidhet njëkohësisht me emocionin, hapësirën dhe kohën. Ai nuk përcjell vetëm fakte. Mund të mbartë atmosferë, distancë, ritëm, përsëritje, heshtje dhe gjurmë

përvojash që është e vështirë të komunikohen përmes imazhit. Dëgjimi mund ta lidhë përvojën e së tashmes me të kaluarat e regjistruara. Megjithatë, regjistrimi dhe transmetimi nuk janë kurrë neutralë: kush regjistron, kush flet, kush redakton, kush dëgjohej dhe kush dëgjon mbeten pyetje qendrore kuratoriale për ekipin e festivalit PRISON RADIO. Këtë e marrim parasysh duke krijuar hapësirë të gjerë për improvizim dhe bashkëbisedim në sesionet me mikrofon të hapur gjatë emisioneve radiofonike të drejtpërdrejta.

Nga Kosova, programi hapet drejt përvojave të tjera të burgimit: rrëfimi i një personi të burgosur pafajësisht në Kolumbi, muzika e lidhur me burgun New Bell në Kamerun dhe me burgjet në Malavi, gjurmë të sistemit të burgjeve të Stasit në Gjermani, lista muzikore të kuruara nga artistë iraniane në mërgim, nga artistët e festivalit PRISON RADIO apo nga ekipi kuratorial, si dhe intervista me Pjetër Arbnorin, At Zef Pllumin, Fatos Lubonjën, Yassin al-Haj Saleh-in e të tjerë, krahas librave audio, leximeve, ligjëratave, intervistave, regjistrimeve dokumentare dhe veprave eksperimentale radiofonike.

Programi radiofonik nuk synon të paraqesë një përvojë universale të burgut. Përkundrazi, ai hap një dritare drejt mënyrave të ndryshme se si njerëzit e kanë përjetuar, mbijetuar, studiuar, kujtuar dhe trajtuar artistikisht izolimin. Radioja i lidh këto përvoja pa i njëjtësuar ato. Për 72 orë, ish-Burgu i Prishtinës, Hani i dy Robertëve dhe rrjetet radiofonike rreth tyre shndërrohen në transmetues dhe marrës: hapësira liminale ku dija e heshtur bëhet e dëgjueshme, ku zërat kapërcejnë muret dhe ku dëgjimi shndërrohet në një praktikë të përbashkët shoqërore.

Burgu i Idealit

Muzeu i Burgut të Prishtinës
BURGU I IDEALIT

Muzeu i Burgut të Prishtinës *Burgu i Idealit* ndodhet në ndërtesën e ish-Qendrës së Paraburgimit në Prishtinë, e njohur si Burgu i Qarkut. E ndërtuar në vitet '50 të shekullit XX, ajo funksionoi deri në vitin 1999 dhe gjatë kësaj periudhe u bë vend burgimi, hetimi dhe torture për mijëra veprimtarë politikë, aktivistë, disidentë dhe të burgosur të tjerë, veçanërisht pjesëtarë të organizatave politike shqiptare përgjatë periudhës jugosllave.

Burgu i Idealit ishte edhe burg i ideve: çdo mendim, kërkesë apo ide që sfidonte rendin politik të kohës dhe konceptonet bazike të regjimit, persekutohej, burgosej e shtypej. Sot, muzeu e ruan këtë fragment të kësaj rezistence, si hapësirë dëshmie, reflektimi e kujtese.

Organizata *Molla e Kuqe*, në kuadër të projektit për funksionalizimin e hapësirës së muzeut, të mbështetur nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për vitet 2024 - 2026, ka realizuar një seri aktivitete në fushën e kulturës dhe artit, të cilat trajtojnë temat e kujtesës, narrativave mbi të kaluarën dhe transformimeve që kanë karakterizuar historinë e të burgosurve shqiptarë gjatë periudhës jugosllave dhe më gjerë.

Aktivitetet e Molla e Kuqe

shpalosen përmes formave të ndryshme artistike, duke trajtuar përvojat e vështira të burgimit dhe kujtesën e të burgosurve përmes strukturave narrative që hapin horizonte të reja interpretimi. Këto qasje rikthejnë dhe interpretojnë përvojat e së kaluarës, si dhe sjellin perspektiva të reja që i japin trashëgimisë historike një forcë të re shprehëse dhe një dimension bashkëkohor.

Aktivitetet si *Njeriu në burg i numëron të gjitha, Çka po sheh, What is Light For?, Eferveshenca kolektive* dhe shfaqja *Qark i (pa)mbyllur burgjesh* e shumë të tjera, synojnë që përvojat e lidhura me këtë hapësirë reale-historike të bëhen më të prekshme dhe më të afërta për vizitorët.

Molla e Kuqe do të organizojë vizita të veçanta me guidë gjatë Festivalit PRISON RADIO.

Adina Camhy u lind në Graz, jeton në Vjenë (Austri). Camhy ka studiuar arkitekturë në Universitetin Teknik të Grazit dhe në Universitat Politëcnica de València (Spanjë), aktualisht ndjek studimet master në Critical Studies në Akademinë e Arteve të Bukura në Vjenë. Veprat e saj shtrihen në praktiva të ndryshme mediale si tingulli, videoja dhe arti pamor. Ato janë prezantuar në hapësira publike, pishina dhe kafene, si dhe nëpër festivale, kinema dhe ekspozita. Camhy hulumton, dekonstrukton dhe rikombinon. Muzika e Camhy-t është pjesë e performancave, filmave dhe radiodramave. Interesat e saj përqendrohen te çështjet urgjente të së tashmes, si teknologjia, historia dhe kujtesa, periferia dhe defekte tjera që nuk duken në sipërfaqe.

Për PRISON RADIO ajo krijoi instalacionin sonor që të mos ndiheshim kurrë vetëm. Ky titull është citat nga intervista me Teuta Bekteshin, ish e burgosur politike, e realizuar nga Oral History Kosova, dhe i referohet mënyrës se si të burgosurit komunikonin me njëri-tjetrin. Vepra i referohet sinjaleve, trokitjeve që përdorshin për të komunikuar përmes mureve dhe tubave të radiatorëve. Këto sinjale akustike u bënë shprehje e solidaritetit dhe shpresës mes të burgosurve: shembull, ato përdorshin për të paralajmëruar praninë e rojeve të burgut, për të thirrur një grevë ose thjesht për të uruar njëri-tjetrin me “natën e mirë”. Instalacioni sonor përjetohet në mënyrë hapësinore dhe plotësohet me citate nga ish-të burgosur politikë.

Në koncertin live, Camhy ndërthur vepra dhe improvizime të krijuara gjatë tre viteve të fundit, gjatë periudhës ku ajo

u përballë me sindromën post-COVID: incizime në terren nga peizazhi i ashpër karstik, improvizime të regjistruara në organo prej druri në një kishë fshati alpin, si dhe fragmente poetike që trajtojnë shpresën dhe sëmundjen kronike. Muzika e Camhy-t përfshin tinguj elektronikë, incizime në terren, vokale dhe efekte, duke krijuar peizazhe sonore delikate, tjetërsuese dhe fragmentare, që lëvizin mes zhurmës dhe ambientit e deri te dronët dhe industria. Në koncert përfshihen tinguj, këngë solidariteti, dhe kujtime të fragmentuara nga Burgu i Prishtinës.



© Thomas Krempke

Lumpen Station u themelua në vitin 2019, si platformë e pavarur radiofonike online, që i përkushtohet artit bashkëkohor, tingullit dhe transmetimit eksperimental. E konceptuar si hapësirë për prodhim artistik, ajo organizon radio-happenings, transmetime specifike për e nga vendndodhja, arkiva sonore dhe bashkëpunimi ndërdisiplinor me artistë, kuratorë, muze, festivale dhe hapësira kulturore. Duke ndërthurur transmetimin e drejtpërdrejtë, improvizimin, instalacionin dhe mjetet digjitale, Lumpen Station eksploron radion si një medium artistik të aftë për ta zgjeruar performancën përtej hapësirës fizike. Krahas produksioneve autoriale, platforma mirëpret edhe projekte bashkëpunuese që ndajnë vizione të afërta editoriale, duke nxitur eksperimentimin, dialogun dhe forma të reja të shkëmbimit artistik në kontekste lokale dhe ndërkombëtare.

Andrea Marioni (1986) është artist, kurator dhe themelues i Lumpen Station nga Zvicra. Praktika e tij interdisiplinore lëviz ndërmjet performancës, instalacionit, fotografisë, tingullit dhe radio-hapeningut, duke hulumtuar ndërthurjet mes psikologjisë, kujtesës kolektive dhe ritualeve shoqërore. Ato kryesisht mbështeten në hulumtimin në terren, kulturën DIY (Do It Yourself) dhe artin konceptual, që transformon materiale të gjetura dhe situata të përditshme në përvoja kritike dhe poetike. Krahas praktikës artistike, ai zhvillon iniciativa të drejtuara nga artistët dhe projekte kuratoriale që vënë në plan të parë eksperimentimin, bashkëpunimin dhe praktikat e bazuara në proces. Puna e tij vë në pikëpyetje kufijtë konvencionalë ndërmjet artistit dhe kuratorit, veprës

së artit dhe ngjarjes, ku situata fluide e pjesëmarrja, perceptimi dhe dialogu bëhen materiale qendrore artistike.

Për PRISON RADIO Lumpenstation udhëheqë 72 orë program e transmetim radiofonik, duke përfshirë performanca të artit radiofonik, intervista, tryeza të rumbullakëta, koncerte, biseda me artistë, studio të hapura dhe intervenime të artit sound, me sesione live dhe studio të hapura në Burgun e Idealit dhe në Hanin e dy Robertëve.



© Lumpenstation

23 Andrés Arizmendy Benavides & Juan Camilo Herrera Casilimas (CO)

Juan Camilo Herrera Casilimas është artist, pedagog dhe hulumtues nga Kolumbia. Praktika e tij shtrihen në krijimin e përvojave që përmes trupit dhe gjuhëve artistike, synojnë të zhvillojnë takime në komunitet, si dhe ndërtimin e dialogëve interkulturore dhe ndërbrezorë, duke nxitur perspektiva të ndjeshme, kritike dhe aktive ndaj realitetit shoqëror. Casilimas është pjesë e CorpoTapioca, një organizatë që zhvillon procese artistike interdisiplinore me popullsitë indigjene në rajonin Orinoko-Amazonë të Kolumbisë, si dhe të Colectivo Libre Colibrí, që zhvillon iniciativa me dhe për fëmijët në Cauca Veriore, Pasto dhe Bogotá.

Andrés Arizmendy Benavides është krijues audiovizual, drejtor fotografie, montazhier dhe artist pamor nga Kolumbia. Praktikën interdisiplinore i manifeston mes filmit, performancës, imazhit, tingullit dhe teknologjive bashkëkohore. Puna e tij fokusohet në filmin artistik, dokumentar, videokërcim dhe instalacion, me një interes të veçantë ndaj marrëdhënieve ndërmjet trupit, kujtesës, territorit, pushtetit dhe përfaqësimit. I angazhuar në procese të krijimit kolektiv, pedagogji dhe prodhim kulturor, praktika e Benavides shtrihet edhe në eksplorimin kritik të mjeteve të inteligjencës artificiale brenda praktikave artistike dhe audiovizuale. Për PRISON RADIO, bashkë me Juan Camilo kanë realizuar instalacionin Celda B-8 ¼, që i dedikohet jetës dhe veprës së Miguel Ángel Beltrán.

Në vitin 2009, sociologu kolumbian Miguel Ángel Beltrán u arrestua për lidhjen me guerrilën FARC nga qeveria e Álvaro Uribe Vélez, brenda politikës

së ashtuquajtur “siguria demokratike”, të harmonizuar me përpjekjet antiterroriste të Shteteve të Bashkuara. Ky montim gjyqësor i kushtoi gjashtë vjet burgim dhe i la një stigmë që vazhdon të ekzistojë edhe pas lirit. Duke u mbështetur në dëshminë dhe në reflektimet mbi sistemin e burgjeve, ata paraqiten me një ese të zgjeruar që synon të përmbysë rendin ndijor dhe simbolik të burgut. Përmes një takimi dhe përvoje dëgjimore, ata kontribuojnë njëkohësisht në angazhimet urgjente që krimet shtetërore të bëhet më të dukshme, si dhe reparacioni simbolik viktimave t’iu mundësohet.



© Andrés Arizmendy Benavides & Juan Camilo Herrera Casilimas

Anouk Albrecht është artiste interdisiplinore, rezidente në Nyrëmbërg dhe Amsterdam. Aktualisht ka përfunduar studimet e Bachelor-it në departamentin e Arteve të Bukura në Gerrit Rietveld Academie dhe diplomon vitin e ardhshëm në Akademinë e Arteve të Bukura të Nyrëmbërgut në Gjermani. Për disa vjet ka qenë anëtare e kolektivit të zërit Dynamic Acoustic Research, që eksploron hapësirën përmes zërit dhe formave kolektive të dëgjimit.

Nisur nga kuptimi i artit si proces relacional dhe i paqëndrueshëm, vepra e saj merr pikënisje rrethanat nën të cilat trupat bëhen të pranishëm. Ajo punon në instalacion, skulpturë, video, tekst dhe zë për të gjurmuar performancën si gjendje ekspozimi, përsëritjeje dhe kujdesit ndaj integritetit personal. E interesuar për tensionin midis qëndrueshmërisë dhe dështimit, dhe për momentin kur performanca fillon të humbasë sovranitetin e vet.

Episodi 6 është një seri performancash nomade të vazhdueshme. E prezantuar me një deri në tre artistë në vende të ndryshme, çdo edicion është specifik për vendin. Performanca ndërtohet mbi mikrofonë radioje të brishtë, të bërë vetë, dhe mbi paaftësinë e tyre për të transmetuar me besueshmëri sinjale audio. Ndërsa artistja është e pajisur me një nga këta mikrofonë dhe një radio që është rregulluar në frekuencat e mikrofonit dërgues në dorën e saj. Dështimi trajtohet jo si një problem teknik, por si një kusht koreografik. Duke funksionuar si një stacion i vogël radiofonik pirat me një rreze transmetimi prej rreth 25 metrash, mikrofoni transmeton në spektrin lokal radiofonik. Performuesja ekziston njëkohësisht në hapësirën fizike dhe në fushën radiofonike, duke punuar vazhdimisht për të krijuar, ruajtur dhe rikthyer një lidhje ndërsa ajo ndërpritet. Zërat, muzika, lajmet dhe reklamat hyjnë në performancë, duke ndryshuar kontekstin e saj — herë duke mbuluar performuesen, e herë të tjera të ndërprera nga veprimet e saj.



Elife (Eli) Krasniqi është antropologe historiane dhe shkrimtare. Hulumtimi i saj përqendrohet te gjinia, kujtesa, lëvizjet shoqërore, pabarazitë historike dhe historitë e marginalizuara. Nga viti 2018 deri në vitin 2023, ajo dha mësim dhe zhvilloi kërkime në njësinë e Historisë dhe Antropologjisë së Evropës Juglindore (SEEHA), në Institutin e Historisë në Universitetin e Grazit. Aktualisht është studiuese postdoktorale SEED Fellow në Universitetin e Regensburgut, në kuadër të SEEHA. Prej shumë vitesh, në mënyrë të vazhdueshme, ajo ka hulumtuar aspekte të ndryshme të lëvizjes së rezistencës, e njohur gjerësisht si Ilegalja. Vitet e fundit, vëmendja e saj është përqendruar te politika e arkivave dhe dimensionet gjinore të arkivave të kësaj lëvizjeje.

Për PRISON RADIO ajo kontribuon me një ligjëratë me titull Histori të rezistencës dhe burgosjes nga perspektiva gjinore, si dhe me një masterclass me titull Arkiva në pezullim: Kohështrirjet e Lëvizjes së Rezistencës në Kosovë.

Në ligjëratën e saj, ajo do të shqyrtojë historinë gjinore të Lëvizjes Shqiptare të Rezistencës në Kosovë, e njohur gjerësisht si Ilegalja. Fillimisht do të paraqitet një histori e shkurtër e lëvizjes, për t'u ndalur më pas te përvojat e grave në rezistencë dhe në burgim. Përmes rrëfimeve dhe përvojave të shpërndara në ditarë, këngë, histori gojore dhe burime të tjera, ligjërata do të gjurmtojë genealogjitë e rezistencës së grave dhe do të shtrojë pyetjen se çfarë na lejojnë të shohim këto burime. Në veçanti, ajo do të shqyrtojë se si këto forma arkivore nxjerrin në pah jo vetëm dimensionet politike të përvojave të grave në rezistencë dhe burgim, por

edhe dimensionet e tyre afektive.

Masterclass e saj Arkiva në pezullim: Kohështrirjet e Lëvizjes së Rezistencës në Kosovë eksploron arkivin e fragmentuar dhe të shpërndarë të Lëvizjes Shqiptare të Rezistencës në Kosovë, e njohur gjerësisht si Ilegalja. Ditarët, shkrimet e burgut, botimet ilegale, procesverbalet gjyqësore, këngët dhe dëshmitë e mëvonshme janë krijuar në momente të ndryshme historike dhe në kushte të ndryshme mundësie. Në vend që t'u qaset këtyre materialeve si një arkiv i paplotë që pret të plotësohet, masterklasa shtron pyetjen se çfarë mund të na tregojnë temporalitetet e tyre të pabarabarta për rezistencën dhe mënyrat se si ajo mund të njihet historikisht. Përmes materialeve të përzgjedhura, pjesëmarrësit do të shqyrtojnë se si ilegaliteti, burgosja, fshehja, rrëfimi retrospektiv dhe njohja e vonuar ndikojnë në atë se çfarë hyn në arkiv, kur bëhet i qasshëm dhe si mund të interpretohet.



Elsa Demo është gazetare e pavarur shqiptare për artet dhe kulturën prej vitit 2000. Bashkë me studiuesin Ardian Klosi ka përgatitur antologjitë Shqipëria kujton 1944-1991 dhe Shqipëria tregon 1991-2010. Është autore e Te Teatri (shënime kritike, ese, polemikë) dhe e disa dramave: E gjelbër hiri në të zezë (prezantuar në Dramatikerinnenfestival, Graz), Era e njeh trupin tim (fituese e Eurodram 2026-Shqipëri); Njeriu që ndjente gjithçka frymëzuar nga përrallat e At Donat Kurtit, të cilën dhe e vuri në skenë, dhe së fundi Salambo lexon gazetën. Elsa jeton në Tiranë. Për PRISON RADIO ajo ka hapur arkivat e saj dhe po kontribuon në mënyra të ndryshme. Ne një qeli në burg, për shembull, i kushtohen intervistës së saj ikonike me Zef Pllumin.

Në esenë e saj radiofonike Prej heshtjes së fjalëve, ajo ngre pyetjen nëse, nën represion të lartë, “letërsia e lirë” është fare e mundur: “E vërtetë që Shqipëria nën diktaturë bashkëjetoi për 45 vjet me një model hegjemon kulturor, por kjo nuk do të thotë që nuk u krijua letërsi e lirë. U shfaq në heshtje si një kundërkulturë, si një mënyrë rezistence tek disa autorë që provuan internimet, burgun politik, kampet e punës së detyruar, disa edhe çmendenin. Bashkë me autorët, nga ato vende kohës sonë i mbërritën tekste të gjalla, të tjera u shkruan në kujtesë brenda mureve, në izolim, për t’u bërë tekst në Shqipërinë e lirë, duke i kompensuar botës shqiptare disa vlera humane universale, të cilat parajsja komuniste i kishte përzënë nga kopshti i saj.”

Për kontributin e saj të dytë live, Nga hiri i imazheve, në dialog me Krenar

Zejnon gjatë sesioneve të drejtpërdrejta të radios, ajo flet për Maks Velon, i cili u arrestua dhe dënua në vitin 1978, i akuzuar pse me inspirimet nga Modigliani-i, Braque-u dhe Picasso-ja, iu kundërvu metodës së realizmit socialist. Policia sekrete i sekuestroi dhe dogji rreth 264 vepra. Ai ia doli të shpëtojë një cikël vizatimesh abstrakte të vitit 1964, titulluar Tri shenjëza dhe një figurë e shtrirë, punuar në lavi. Mund të thuhet se janë veprat e para të artit abstrakt e surreal në Shqipëri.


Elsa Demo dhe Krenar Zejnon rindërtojnë përmes dialogut profilin e një artisti eksentrik dhe polemik që hyn e del lehtësisht nga arkitektura tek artet figurative dhe letërsia. Ai mbeti deri në fund aktivist në mbrojtje të trashëgimisë kulturore, interlokutor mediatik dhe nxitës i mprehtë i debateve mbi rolin e artistit nën diktaturë.



© Elsa Demo

Eva Buzo është një notuese shqip-tare-australiane e ujërave të hapura në distanca të gjata, e cila në vitin 2024 përfundoi kalimin prej rreth 92 kilometrash të Ngushticës së Otrantos nga Italia në Shqipëri, duke notuar pa ndërprerje për më shumë se 35 orë dhe duke u bërë gruaja e parë që e përfundoi këtë kalim. Notimet e saj në notin e distancave të gjata përfshijnë gjithashtu Kanalin Anglez dhe itinerarin nga Juanchaco në Buenaventura, në Kolumbi. Duke u lëvizur nëpër rrjedha, temperatura dhe kushte të ndryshme moti, praktika e Buzos formësohet nga qëndrueshmëria fizike dhe mendore dhe marrëdhënia midis trupit, distancës dhe ujit të hapur. Përveç notit, ajo punon ndërkombëtarisht si avokate e të drejtave të njeriut, me fokus në të drejtën penale ndërkombëtare dhe të drejtat e njeriut.

Për PRISON RADIO, ajo do të kontribuojë me 7K vrapimin poetik komunitar Endem me fenerë duke kërkuar vetveten në Parkun e Gërmisë së bashku me alpinisten Uta Ibrahim, si dhe me bisedën me Ebi Spahiun e cila e shoqëroi me barkë kalimin e saj nga Italia në Shqipëri. Së bashku, ato do të flasin për kufijtë, fuqinë mendore, çfarë do të thotë të notosh në distancë aq të madhe, sfidat fizike dhe mendore të notit në distancë të largët, si dhe llojin e shoqërisë dhe besimit që mund të nxisë një përvojë e tillë.



Shoqata e Radioamatorëve të Kosovës (SHRAK) promovon dhe zhvillon komunikimet radioamatore në Kosovë, duke u përqendruar në njohuritë teknike, edukimin, angazhimin e komunitetit dhe komunikimin në raste emergjente.

SHRAK-u organizon programe trajnimi për radioamatorët e rinj, punëtori praktike dhe veprimtari teknike që lidhen me radiokomunikimin, përhapjen e valëve HF, sistemet e antenave, teknologjinë radiofonike dhe aftësitë operative. Shoqata promovon gjithashtu rolin e rëndësishëm të radios amatore në komunikimet gjatë emergjencave dhe fatkeqësive, duke punuar për të forcuar gatishmërinë dhe qëndrueshmërinë e komunikimit.

Përmes rrjeteve, garave dhe ngjarjeve kombëtare e ndërkombëtare të radioamatorëve, SHRAK-u i lidh radioamatorët e Kosovës me komunitetin më të gjerë botëror dhe i nxit të rinjtë të merren me elektronikën, telekomunikacionin dhe teknologjitë praktike të komunikimit.

Për PRISON RADIO, SHRAK-u e shndërron praktikën e transmetimit, marrjes dhe kërkimit nëpër frekuenca në pjesë të një eksperimenti sonor drejtpërdrejt. Gjatë koncertit Tonic Train, anëtarët e shoqatës do të formojnë një orkestër radiofonike në çatinë e Burgut të Idealit, duke përdorur radiot e tyre amatore për të kapur çfarëdo sinjalesh, zërash, fragmentesh, zhurmash dhe transmetimesh që mund të marrin nga eteri përreth. Këto sinjale radiofonike të drejtpërdrejta do të bëhen pjesë e koncertit, duke e hapur burgun ndaj frekuencave që udhëtojnë përtej kufijve gjeografikë dhe fizikë.



© SHRAK

Hazir Reka, i lindur më 1961 në Ferizaj, Kosovë, filloi karrierën si fotoreporter në vitin 1984 në Bota e Re dhe më vonë punoi për Zëri. Fotografitë e tij dokumentare dhe artistike janë botuar në shumë media ndërkombëtare, përfshirë The New York Times, International Herald Tribune dhe Libération. Që nga viti 1998, Reka punon si fotograf për Reuters. Ai ka dokumentuar luftën e Kosovës, nga ngjarjet në Prekaz deri në hyrjen e trupave të KFOR-it, siç i përcolli edhe të gjitha zhvillimet politike në Kosovë që nga vitet 1980. Veprat e tij janë ekspozuar ndërkombëtarisht dhe botuar në disa libra. Fotografia e Rekës përbën një dëshmi të rëndësishme vizuale të luftës, ndryshimeve shoqërore dhe jetës së përditshme në Kosovë.

Për PRISON RADIO, ai hapi arkivin e tij me një fotografi të rrallë, të shkrepur nga jashtë ish-Burgut të Prishtinës.

Veton Surroi, udhëheqës i Partisë Parlamentare të Kosovës, u arrestua më 26 qershor 1991 dhe u dënua me 60 ditë burgim, me akuzën se kishte prishur rendin publik. Ai kishte marrë pjesë në organizimin e një demonstrate të heshtur në Prishtinë, Varrimi i dhunës më 13 qershor 1991, kundër dhunës që po ushtrohej nga autoritetet serbe kundër shqiptarëve. Demonstrata nuk ishte autorizuar zyrtarisht. Surroi u arrestua pavarësisht karakterit paqësor të protestës. Amnesty International e konsideroi atë të burgosur për arsye të ndërgjegjes, duke e parë dënimin e tij si të padrejtë dhe politik.

Në dalje nga burgu, ai ishte i shoqëruar nga avokati i tij Bajram Kelmendi, i ekzekutuar me dy bijtë e tij në mars 1999.

“Fotografimi i daljes së Veton Surroi nga burgu është bërë në mënyrë të fshehtë sepse ka qenë e ndaluar të fotografohet burgu. E kam marrë informtën nga avokati Bajram Kelmendi që do të lirohet Veton Surroi dhe jam përgatitur, kam fotografuar nga dritarja e një vetureje.” Hazir Reka



© Hazir Reka: Dalja nga Terri, 1991

Ilir Bajri është kompozitor, pianist, artist i tingullit dhe praktikues kulturor kosovar që punon në fushën e muzikës, improvizimit, tingullit dhe praktikës artistike ndërdisiplinore. Në punën e tij shpesh merret me eksperimentimin, bashkëpunimin dhe marrëdhënien midis tingullit, hapësirës dhe kujtesës. Për Festivalin PRISON RADIO, Bajri zhvillon një vepër të re live, në të cilën zëri, manipulimi elektronik dhe improvizimi e shndërrojnë gjuhën e disiplinës së Foucault-së në material tingullor.

Ai hap festivalin PRISON RADIO me një interpretim tingullor nga vepra Disiplinë dhe Ndëshkim të Michel Foucault-së. Fragmente të veprës themelore të Foucault-së regjistrohen në disa gjuhë, pastaj përsëriten, shtresëzohen, filtrohen dhe gradualisht fragmentohen në fjalë, rrokje, frymë dhe zhurmë. Vetë gjuha i nënshtrohet përsëritjes, renditjes, ndërprerjes dhe kontrollit, duke pasqyruar mekanizmat disiplinorë që Foucault i gjurmon nga burgjet në shkolla, fabrika, spitale dhe jetën e përditshme sociale. Megjithatë, ndërsa zërat janë të kufizuar sonikisht brenda ish-Burgut të Prishtinës, performanca transmetohet drejtpërdrejt në radio dhe kështu kalon muret e tij fizike, duke e kthyer tingullin në një mjet për t'u arratisur nga kufizimi.



© Ilir Bajri

Knut Aufermann është artist i radios, muzikant, organizator, shkrimtar, kura-tor dhe ligjërues. Ai interpreton muzikë elektronike të improvizuar duke përdorur forma të ndryshme të feedback-ut të dëgjueshëm. Së bashku me Sarah Washington drejton projektin Mobile Radio, i cili hulumton mënyra alternative të prodhimit radiofonik. Veprat e tyre janë transmetuar nga më shumë se 60 stacione radio në mbarë botën, si edhe janë prezantuar në kontekste galerish, ndër të tjera në Bienalen e 30-të të São Paulos dhe në documenta 14. Në vitin 2016, Knut Aufermann ishte drejtor artistik i Festivalit Radio Revolten në Halle (Gjermani), ndërsa në vitin 2022 bashkëdrejtor artistik i Radio Art Zone në Esch (Luksemburg). Ai është bashkëthemelues i Resonance FM dhe i rrjetit Radia.

Me mbetje & fara Knut Aufermann udhëheqë audiencën në një shëtitje dëgjimore nëpër kompleksin e burgut. Do të dëgjojmë atë që mund të ketë qenë dikur, atë që është e pranishme sot dhe atë që e ardhmja mund të sjellë.

Në masterklasën e tyre Radio mobile: 20 vite të radios si art, Sarah Washington dhe Knut Aufermann prezantojnë një përzgjedhje veprash nga mbi 20 vitet e tyre me Mobile Radio, një projekt i përkushtuar zhvillimit të radios si formë arti. Një nga temat qendrore të punës së tyre është radioja si funksion i vendit, duke nënkuptuar se tingulli dhe energjia formësohen nga hapësira prej së cilës transmetohet radioja. Ata do të ofrojnë një pasqyrë të punës së tyre me një rrjet ndërkombëtar artistësh dhe transmetuesish, duke nxitur pyetje dhe shkëmbimin e përvojave mes pjesëmarrësve.

Krahas këtyre kontributeve, Knut është poashtu pjesë e Tonic Train, duo improvizuese e tij me Sarah Washington. Duke përdorur instrumente elektronike dhe feedbackun si material, Tonic Train krijon kompozime live në të cilat sinjalet vazhdimisht transformohen, ridrejtohen dhe kthehen në vetë zërin.



Portrait photo, © Peter Meyenschein


Kolektiv është një organizatë e pavarur kulturore me seli në Prizren, Kosovë, e cila punon me muzikën si praktikë kulturore, edukative dhe kolektive. Përmes koncerteve, punëtorive, sesioneve të dëgjimit, performancave dhe platformës së saj të radios komunitare, Kolektiv e eksploron muzikën dhe tingullin si mjete për të mësuar, për shkëmbim kulturor dhe për krijim të komunitetit.

Kolektiv Radio do të marrë përsipër Hanin e dy Robertëve dhe do të krijojë një hapësirë për dëgjim, shkëmbim dhe performanca muzikore pas koncerteve të Burgun e idealit. Programi i dëgjimit dhe muzikës do të fillojë çdo ditë nga ora 19.00 dhe do të plotësohet e transmetohet live nga Lumpen Stadion prej Studios Hani.



Toni Dimitrov është artist multimedial dhe sonor, drejtues emisionesh radiofonike, kurator dhe producent kulturor me bazë në Shkup, Maqedoni e veriut. Për më shumë se 20 vjet, ai ka punuar në fushën e radios, muzikës së pavarur dhe artit bashkëkohor. Praktika e tij ndërthur regjistrimet në terren, muzikën ambient, drone dhe eksperimentale, peizazhin sonor dhe artin radiofonik, duke eksploruar kujtesën, vendin, lëvizjet shoqërore, përfytyrimet utopike dhe distopike, si dhe marrëdhënien ndërmjet tingullit dhe hapësirës shoqërore. Ai i shndërron mjediset e regjistruara në material sonor abstrakt për performanca, instalacione, transmetime dhe bashkëpunime. Dimitrov themeloi Élan Vital Recordings dhe Post Global Recordings, ndërsa më parë drejtoi Qendrën e Informacionit Kulturor në Shkup. Ai vazhdon veprimtarinë e tij të pavarur.

Duke dëgjuar pas është një performancë sonore e drejtpërdrejtë, e ndërtuar nga regjistrime në terren dhe manipulimi i tyre në kohë reale. Fragmente peizazhesh, qytetesh, makinerish, zërash dhe hollësish sonore të anashkaluara formojnë një arkiv personal të vendeve dhe çasteve që kanë ndryshuar ose janë zhdukur. Gjatë performancës, këto regjistrime shtresëzohen, zgjaten, përsëriten, filtrohen dhe deformohen, duke krijuar hapësira sonore të panjohura. Vepra hulumton tensionin midis arkivit dhe pranisë, kujtesës dhe transformimit. Brenda PRISON RADIO, tingulli shndërron në transmetim: gjurmët udhëtojnë përtej vendndodhjes së tyre fillestare dhe rimontohen në forma të reja. Duke iu referuar romanit të Edward Bellamy-t të vitit 1888, vepra përfytyron të ardhme të mundshme përmes mbetjeve sonore të një të shkuare tashmë të regjistruar.



TONI DIMITROV + DIONISAF • PASTORAL

Labinot Kelmendi është studiues i filozofisë nga Prishtina. Ai ka doktoruar në filozofi në Universitetin e Zagrebit. Për më shumë se dhjetë vjet ka qenë asistent dhe ligjërues në Universitetin e Prishtinës, ku aktualisht mban titullin akademik profesor asistent. Ai ligjeron lëndët Estetikë, Filozofi Bashkëkohore, Hyrje në Fenomenologji, si dhe Communitas dhe Immunitas.

Kelmendi ka botuar punime shkencore edhe ese kritike mbi artin vizual, muzikën dhe filmin. Ai është anëtar i kryesisë së Shoqatës së Filozofëve të Kosovës, si dhe themelues dhe drejtues i Simpoziumit për Filozofi, Art dhe Teknologji Filozofema. Aktualisht është vokalist i bendit eksperimental/alternativ Elektorati Intelektual.

Ky prezantim propozon zhurmën si një dalje të mundshme nga ky regjim i vizualitetit. Në këtë dritë-hije gjen përdorim neologjizmi i Kadaresë zhurmëhuria (Noiseology) si një kornizë konceptuale që i përmbledh dimensionet ontologjike, estetike dhe socio-politike të zhurmës. Në këtë prezantim argumenti zhvillohet përmes një dialogu ndërmjet Jacques Attali-t, i cili e lexon zhurmën si pasqyrë dhe kushtin ekzistencial të transformimeve shoqërore, Michel Serres-it për të cilin zhurma është sfondi kaotik prej nga gjenerohen sistemet materiale dhe komunikative, si dhe Jean-Luc Nancy-t, tek i cili dëgjimi (listening) artikullohet si një modalitet onto-fenomenologjik i ekspozimit të vibrimit të qenies.



© Prison Radio Team

Maja Zećo, me origjinë nga Sarajeva dhe me bazë në Skoci që nga viti 2015, është artiste dhe hulumtuese ndërdisiplinore që punon në ndërturjen e artit performativ, tingullit dhe imazhit në lëvizje. Hulumtimi i saj përfshin shpesh shëtitje dëgjimore (soundwalks), ekskursione dëgjimi, përmes të cilave ndërvepron me vende të dinamikave komplekse shoqërore dhe politike. Në praktikën e saj performative, eksplorimet kritike të identiteteve, dekolonialitetit dhe futurizmave ballkanikë e kanë çuar Majën drejt vetëvarrimeve, zhytjes në ujë për të rikthyer kujtime, eksperimenteve me kufizimin e shqisave dhe praktikave të qëndrueshmërisë. Ajo e ka prezantuar punën e saj në Mbretërinë e Bashkuar dhe ndërkombëtarisht, përfshirë Australinë, Italinë, Holandën dhe hapësirën e ish-Jugosllavisë.

Rigjurmimi i hapave është shëtitja dëgjimore e Majës nëpër Prishtinë. Gjatë kësaj shëtitjeje dëgjimore në grup (soundwalk), do të eksplorojmë peizazhin bashkëkohor sonor të Prishtinës, duke rigjurmuar rrugën që Blerta përshkonte për të shkuar në shkollë gjatë viteve 1990, një periudhë kur shumë fëmijë u përjashtuan nga shkollat publike dhe u arsimuan në një sistem të improvizuar, jashtë regjimit zyrtar politik. Grupi do të lëvizë nëpër rrugica të ngushta dhe lagje intime, duke dëgjuar me kujdes tingujt përreth, të udhëhequr nga udhëzimet e Majës dhe nga tekstet e Verenës mbi udhëtimet drejt shkollës. Shëtitja do të nisë pranë shtëpisë së Blerit dhe do të përfundojë në vendin ku dikur ndodhej shkolla, e cila sot nuk ekziston më, duke evokuar kujtime dhe përfytyrime të së kaluarës dhe së tashmes.

Me performancën e saj live në lëvizje Defend and Protect / Odbrana i Zaštita / Mbrojtje dhe Ruajtje, Maja eksploron përvojën e tingujve të dronëve ushtarakë, ashtu siç perceptohen nga niveli i tokës. Gjatë performancës, Maja mban veshur një jelek 'antiplumb' të punuar me dorë, të përbërë nga çanta rezistente të mbushura me mbi 20 kilogramë dhe, nga ky jelek emetohen tinguj dronësh.

Vepra vë në pikëpyetje ndjenjën tonë të sigurisë, aftësinë për të vepruar dhe vetëkënaqësinë përballë dronëve ushtarakë, të përdorur si armë dhe si mjete mbikëqyrjeje, që shkaktojnë stres, çrregullim të stresit post-traumatik (PTSD) dhe humbje jetësh. Defend and Protect përfaqëson një veprim sonor në hapësirën publike, që në një nivel më personal krijon hapësirë për reflektim dhe dëgjim në solidaritet me ata që jetojnë nën kërcënime të vazhdueshme. Publiku është i mirëpritur të përdorë telefonat dhe altoparlantët e vet Bluetooth për t'iu bashkuar Majës në këtë veprim zanor.



© Gjorgje Jovanovik

Orgest Azizi është studiues dhe përkthyes i filozofisë dhe shkencave humane.

Ka lindur në Vlorë më 1974 dhe ka studiuar Filozofi dhe Sociologji në Tiranë, Filozofi në universitetin Paris-8, dhe më vonë Filologji klasike greko-latine në Sorbonne Université.


Interesat e tij sillen rreth kategorive të emancipimit, takimit, diskursit, belbëzimit dhe në përgjithësi formave heterogjene të daljes nga vetvetja.

Në shqip ka përkthyer M. Foucault, G. Agamben, P. Ricoeur, E. Weil dhe së fundi një vëllim me ese rreth lliadës nga S. Weil dhe R. Besspaloff.

Për PRISON RADIO, Azizi ka përgatitur ligjëratën Zëra të mbytur, bar i egër, duke ndërthurur rryma të ndryshme, mendime dhe botë të papritura në lidhje me burgun dhe radion. Vitin e kaluar shënuam 50-vjetorin e botimit origjinal të Disiplinës dhe ndëshkimit, përmes lenteve të dritës, burgut si makineri optike, dukjeve dhe zhdukjeve politike të trupit. 2026-a shënon 100-vjetorin e lindjes së Michel Foucault (1926-1984). Ky festival është rasti i eksplorimit të përmasës sonore të veprës së autorit, një praktikues intensiv i radios.

Foucault është po ashtu një “zë teorik”, një nga të parët zëra të fetishizuar - dhe masivisht të regjistruar të teorisë.

Kjo mbiekzistencë sonore – dhe mashkullore, bën kontrast me heshtjen e burgut, dhe mungesën e dimensionit sonor në studimin e tij. Akoma më shumë me dimensionin femëror, edhe të burgut, edhe të zërit. Por burgu është vend i llojlloj zhurmash, mërmërimash, klithmash, rënkimesh, mesazhesh - deri edhe cicërimash. Një afirmim revolucionar i jetës, siç e dëshmon Herbariumi i burgut i Rosa Luxemburgut.



© Rosa Luxemburg, Herbarium

© Orgest Azizi

Oral History Kosovo është iniciativë e pavarur hulumtuese e historisë gojore të gjeneratave, kombësive dhe kompetencave të ndryshme, e përkushtuar ndaj regjistrimit të rrëfimeve jetësore nga Kosova e më gjerë, dokumentimit të tyre dhe vënies në dispozicion të publikut rrëfime nga Kosova e më gjerë. Iniciativa e Historisë Gojore është themeluar në vitin 2012, ajo bashkon hulumtues nga fusha të ndryshme, me qëllim të krijimit të një arkivi të zërave individualë që shpesh mungojnë në historitë zyrtare të Kosovës. Përmes intervistave të filmuara, transkriptimit dhe përkthimit, iniciativa e trajton dëshminë gojore si një formë komplekse të dijes historike, të kujdesshme ndaj kujtesës, kundërthënieve dhe përvojës personale. Oral History Kosovo e vendos kryesisht zërin dhe perspektivën e rrëfimit në qendër, përmes së cilit historitë individuale mund të marrin kuptim plural e më intim ndaj së kaluarës.

Në programin e PRISON RADIO do të transmetojmë fragmente të përzgjedhura dhe të shkurtuara nga intervistat e realizuara nga Iniciativa e Historisë Gojore (KS) me ish-të burgosur politikë dhe aktivistë përgjatë periudhave të rezistencës në Kosovë. Përzgjedhja e dymbëdhjetë intervistave të regjistruara të disa të ish-të burgosurve, shpalosin organizimin politik, rezistencën, hetuesinë, burgimin, represionin si dhe kujtimet intime të disa gjeneratave në Kosovë, siç janë ato të Hydajet Hysenit, Afide Topallit, Rexhep Bunjakut, Berat Luzhës, Zahrije Podrimqakut, Shukrije Gashit, Ibish Nezirrit, Teuta Hadrit, Meriman Brahës, Hava Shalës dhe Hasan Dërmakut.

Intervistat transmetohen me lejen e KOHI përgjatë ditëve të festivalit PRISON RADIO në Prishtinë.

Sarah Washington krijon vepra radiofonike, instalacione dhe ngjarje, si edhe interpreton muzikë të improvizuar me pajisje elektronike të krijuara prej saj. Ajo është bashkëthemeluese e Resonance FM dhe e rrjetit të artit radiofonik Radia. Ndër krijimet e saj artistike përfshihen vepra radiofonike për Tate Modern në Londër (2007), një stacion radiofonik 100-ditor për Bienalen e 30-të të São Paulos (2012), si edhe programe për SAVVY FUNK në kuadër të documenta 14 (2017). Në vitin 2016 ishte bashkëkuratore e festivalit Radio Revolten, ndërsa në vitin 2022 shërbeu si bashkëdrejtore-shë artistike e projektit Radio Art Zone për Esch22. Në vitin 2005 bashkëthemeloi projektin Mobile Radio, i cili ka zhvilluar dhe mësuar artin radiofonik në 23 vende. Antologjia e saj Radio Art Zone u botua nga Hatje Cantz në vitin 2023.

Teksa ngjitemi dhe arrijmë në kabinën e kullës së vrojtimit, prej nga janë larguar tashmë rojet përherë vigjilentë të burgut, do të ndeshemi me një mori pyetjesh. Çfarë qëllimi kishte gjithë ai vëzhgim dhe ndëshkim i një popullsie? Dhe, mbi të gjitha, ndërsa sodisim ndërtesat e rrënuara poshtë nesh, çu bë me ata që u burgosën këtu, çfarë të fshehtash mbajnë ende të gjallët?

Për PRISON RADIO, Sarah realizoi një instalacion sonor të krijuar enkas për këtë vend. Different Light kërkon të ndryshojë energjinë e këndvështrimit, duke u përpjekur të lë gjurmë përmes dy ish-të burgosurve, Akile Dedinca Zhegrova dhe Abdullah Zhegrova drejtpërdrejt në strukturën e këtij vendi thellësisht simbolik të shtypjes. Së bashku kërkojmë ta shndërrojmë një zonë rreziku, të

rënduar nga parandjenja e kërcënimit, në një kremtim të një dashurie të lindur nga qëndresa.

Në masterklasën e tyre Mobile Radio: 20 vite të radios si art, Sarah Washington & Knut Aufermann prezantonë një përzgjedhje veprash nga mbi 20 vitet e tyre me Mobile Radio, një projekt i përkushtuar zhvillimit të radios si formë arti. Një nga temat qendrore të punës së tyre është radioja si funksion i vendit, duke nënkuptuar se tingulli dhe energjia formësohen nga hapësira prej së cilës transmetohet radioja. Ata do të ofrojnë një pasqyrë të punës së tyre me një rrjet ndërkombëtar artistësh dhe transmetuesish, duke nxitur pyetje dhe shkëmbimin e përvojave mes pjesëmarrësve.

Sarah është gjithashtu pjesë e Tonic Train, duos së saj shumëvjeçare të improvizimit me Knut Aufermann. Duke përdorur instrumente elektronike dhe feedback-un si material, Tonic Train krijon kompozime të drejtpërdrejta, ku sinjalet transformohen vazhdimisht, ridrejtohen dhe rikthehen në vetë tingullin.



© Private Family Archive of Akile Dedinca Zhegrova & Abdullah Zhegrova

Pas studimeve në Klasën e Fotografisë në Cyrih (Fotoklasse Zürich), Thomas Krempke punoi si filmbërës. Ai ishte një nga autorët e filmit kult zviceran *Züri brännt* (1981) dhe punoi si drejtor fotografie për produksione ndërkombëtare filmike, si edhe si kurator në festivale filmi. Që nga viti 2008, fotografia është në qendër të praktikës së tij artistike. Veprat e tij eksplorojnë marrëdhënien ndërmjet imazhit dhe tekstit, duke vënë në pikëpyetje mënyrën se si perceptojmë. Libri i tij *The Whispering of Things* u botua nga Edition Patrick Frey në vitin 2019. Ka marrë pjesë në një sërë ekspozitash personale dhe kolektive. Që nga viti 2020, ai po punon në projektin afatgjatë *Ëndërr!*, një eksplorim i shikimit fotografik dhe i perspektivës mbi realitetin shqiptar.

Duke marrë frymëzim nga poezia *Ëndërrat*, e shkruar nga Visar Zhiti në vitin 1982 ndërsa ishte i burgosur në burgun shqiptar të Spaçit, instalacioni *Befas u zgjove...* eksploron marrëdhënien midis ëndrrave, pritshmërive dhe realitetit përmes imazheve, muzikës, tingullit dhe tekstit. Poema dëgjohet me vështirësi, por shfaqet qartë në gjuhën e shenjave, enigmatike dhe e kuptueshme, si gjuha e një ëndrre: "Patjetër je duke ëndërruar / se ëndrrave pranga s'u vënë dot." Derisa të zgjohesh - e pastaj çfarë?

Instalacioni u krijua posaçërisht për festivalin *PRISON RADIO* në ish-Burgun e Prishtinës.

Interpretimi në gjuhën e shenjave nga Franceska Xhunga; muzika nga Francesco Giudici.



Tonic Train është themeluar në vitin 2000 nga duo i elektronikës eksperimentale Sarah Washington dhe Knut Aufermann, që në thelb bashkon dy metoda të muzikës së hershme elektronike: përvetësimin e qarqeve elektronike (i njohur si circuit bending) dhe përdorimin jo-konvencional të pajisjeve elektronike (i njohur si no-input mixing desk). Gjithashtu ata përdorin radio dhe pajisje ultrasonike. Qasja artistike e Tonic Train ka ngjashmëri me eksperimentet e muzikës elektronike të David Tudor. Dyshja ka zhvilluar turne dhe performanca së bashku me pionierin e artit sonor Alvin Lucier.

Për PRISON RADIO, Tonic Train ka ftuar tashmë Shoqatën e Radioamatorëve të Kosovës që të performojë së bashku në një koncert të dedikuar hapësirës në oborrin e burgut, duke përdorur rrjetën e çatisë së hapur për të kapur radio-sinjale dhe për t'i sjellë ato brenda burgut. Radioamatorët kthehen në instrumente muzikore, duke prodhuar interferime e duke nderthurur tingujt e oborrit të burgut me radio-sinjalet nga qyteti dhe më gjerë.



© Tonic Train

Uta Ibrahim është një alpiniste kosovare e cila, në maj 2025 u bë personi i parë nga Ballkani që ngjiti të gjitha 14 malet e botës mbi 8,000 metra, duke përfunduar një udhëtim tetëvjeçar nëpër majat më të larta të botës. Në vitin 2017, ajo tashmë ishte bërë gruaja e parë shqiptare që arriti në majë të Malit Everest. Praktika e saj alpiniste formësohet nga qëndrueshmëria fizike dhe mendore, periudhat e gjata në mjedise ekstreme dhe një lidhje e ngushtë me malet dhe natyrën. Ibrahim është gjithashtu themeluese e Butterfly Outdoor Adventures dhe e Fondacionit Utalaya, përmes të cilave promovon alpinizmin, kulturën e jashtme, ndërjegjësimin mjedisor dhe angazhimin me natyrën.

Për PRISON RADIO, Uta dhe ultra notuesja Eva Buzo sjellin përvojat e tyre në një vrapim kolektiv 7K nëpër Parkun Gërmia. Vrapimi Poetik Komunitar i qaset stërvitjes si një praktikë e përbashkët e lëvizjes dhe qëndrueshmërisë, duke gjetur një ritëm dhe duke përjetuar distancën përmes trupit. Nëpër male dhe ujëra të hapura, Uta Ibrahim dhe Eva Buzo kanë zhvilluar praktika të jashtëzakonshme qëndrueshmërie, duke lëvizur për orë e ditë të tëra mes mjediseve në ndryshim, motit, rraskapitjes dhe kufijve fizikë e mendorë.

Gjatë vrapimit, Uta dhe Eva i përgjigjen nxitjeve poetike rreth peizazhit, trupit, qëndrueshmërisë dhe forcës mendore. Biseda pyet se çfarë i formëson praktikën e tyre dhe çfarë ndodh kur trupi arrin kufijtë e tij: kur mundëson trupi lirinë dhe lëvizjen, dhe kur mund të bëhet një formë burgimi? Përgjigjet e tyre bëhen pjesë e një bisede radiofonike lëvizëse rreth qëndrueshmërisë, forcës mendore, kufijve fizikë dhe çfarë do të thotë të vazhdojë përpara.

Vrapimi dhe biseda do të regjistrohen dhe do të transmetohen në PRISON RADIO.

Ky është një vrapim komunitar, jo një garë.



© Uta Ibrahim

RADIO LIVE

Lumpenstation

Çdo ditë nga ora 12:00, radio drejtpërdrejt nga Studio Burgu në Burgu i Idealit, dhe nga ora 19:00,

Radio drejtpërdrejt nga Studio Hani në Hani i dy Robertëve.

Kolektiv Radio

Sesione dëgjimi & muzike

10–12 shtator 2026

Çdo mbrëmje duke filluar nga ora 19:00

Hani i dy Robertëve
Studio Hani

LIGJËRATA

Labinot Kelmendi

Noisology: Zhurma si pasqyrë e shoqërisë

E premte, 11 shtator 2026
16:00

Burgu i Idealit
Shëtitorja e Madhe
Studio Burgu

Elife (Eli) Krasniqi

Histori të gjinorizuara të rezistencës dhe burgosjes

E premte, 11 shtator 2026
17:00

Burgu i Idealit
Shëtitorja e Madhe
Studio Burgu

Orgest Azizi

Zëra të mbytur, bar i egër

E shtunë, 12 shtator 2026
17:00

Burgu i Idealit
Shëtitorja e Madhe
Studio Burgu

Elsa Demo

Nga heshtja e fjalëve

Ese radiofonike drejtpërdrejt

E shtunë, 12 shtator 2026
16:00

Burgu i Idealit
Shëtitorja e Madhe
Studio Burgu

MASTERKLASA

Sarah Washington & Knut Aufermann

Mobile Radio: 20 vjet radio si art

E premte, 11 shtator 2026
10:30–12:00

Burgu i Idealit
Shëtitorja e Vogël

Elife (Eli) Krasniqi

Arkiva në pezullim: Temporalitetet e

Lëvizjes së Rezistencës në Kosovë

E shtunë, 12 shtator 2026
10:30–12:00

Burgu i Idealit
Shëtitorja e Vogël

NGJARJE KOMUNITARE

Uta Ibrahim & Eva Buzo

“Kam dalë me fenerë, duke kërkuar veten.”

Vrapim poetik komunitar 7K

E premte, 11 shtator 2026

09:00–10:00

Pika e takimit:
Parku i Gërmisë: Stacioni i autobusit

Maja Zeço
Retracing Steps
me Blertë Ismajli dhe Verena Walz
Shëtitje sonore
E diel, 13 shtator 2026
10:00

Pika e takimit: Përmendorja
Bajram Kelmendi (Dragodan)

Regjistrimi: info@stralli.org
ose në Burgu i Idealit

Numër i kufizuar i pjesëmarrësve

KONCERTE

Ilir Bajri
Koncerti i hapjes
10–13 shtator 2026
17:00

Burgu i Idealit
Shëtitorja e Madhe
Studio Burgu

Tonic Train feat. HAM Radio
Orchestra Kosova
Koncert
E premte, 11 shtator 2026
18:00

Burgu i Idealit
Shëtitorja e Madhe
Studio Burgu

Adina Camhy
E shtunë, 12 shtator 2026

18:00

Burgu i Idealit
Shëtitorja e Madhe
Studio Burgu

Toni Dimitrov
Listening Backward
Performancë muzikore
E shtunë, 12 shtator 2026
Duke filluar nga ora 20:00

Si pjesë e sesioneve të dëgjimit
& muzikës të Kolektiv Radio

Hani i dy Robertëve
Studio Hani

PERFORMANCA

Maja Zećo

**Defend and Protect / Odbrana i Zaštita
/ Mbrojtje dhe Ruajtje**

Performancë live

E premte, 11 shtator 2026

15:00

Burgu i Idealit

Anouk Albrecht

Episode 6

Performancë

E shtunë, 12 shtator 2026

15:00

Burgu i Idealit

Shëtitörja e Madhe

Studio Burgu

Knut Aufermann

Shëtitje dëgjimore e orientuar /

Performancë përmbyllëse

remnants & seeds

E diel, 13 shtator 2026

11:30–12:00

Burgu i Idealit

Hyrja

Radio Program

→**17.00**

PRISON x PRISON

Hapja e Festivalit të Radios së Burgut drejtpërdrejt nga ish-Burgu i Prishtinës

PRISON x ARCHIPELAGO

Koncerti i hapjes - Ilir Bajri (KS)
Interpretim tingullor nga vepra *Disiplinë dhe Ndëshkim* e Michel Foucault-së

PRISON x RADIO LIVE

Stacioni Lumpen (CH) drejtpërdrejt nga "Burgu i Idealit"

PRISON x BURNING 1

Pas koncertit "Brennung 1" Instalacion sonor nga Holger Czukay, bazuar nga kujtimet e Arthur Schmidt gjatë burgosjes në Burgjet e Stasit në RDGJ

→**20.00 - 00.00**

PRISON x NIGHTS

Kolektiv Radio (KS) organizon një seancë dëgjimore me muzikë live nga Hani i dy Roberteve, bashkë me Agonën dhe Somerin

Lumpen Station (CH) Live nga Hani i dy Robertëve

→**00.00 - 8.00**

PRISON x LISTENING

Tinguj dedikues, art radiofonik, lexim i poezive dhe intervista mbi burgosjen dhe përvojat e burgosjes me Karim Ait-Gacem – Radio Parloir: Voices from Lantin me 15 ans. Pjesë të përzgjedhura nga materialet audio të krijuara gjatë një punëtorie

radiofonike me të burgosurit e Lantinit në Valoni, Belgjikë. Pjesa është në gjuhën frënge.

111 është një instalacion sonor i artistit brazilian Nuno Ramos, që i përgjigjet masakrës së Burgut Carandiru në São Paulo në vitin 1992, ku policia ushtarake vrau 111 të burgosur. Ky instalacion u krijua si pjesë e përkujtimit të 20-vjetorit të masakrës. Artisti brazilian Nuno Ramos lexon emrat e 111 të burgosurve. Vepra është në gjuhën portugeze.

Diána Vonnák & Bálint Halle Alien, Ghost është një seri meditimesh audio mbi dëshminë dhe bashkëfajësinë, të nxjerra nga puna antropologjike në Ukrainën e kohës së luftës. Përmes portreteve, peizazheve zanore, ëndrrave dhe reflektimeve, ndjek çorientimin, zemërimin, pikëllimin dhe fajin e të vëzhguarit të luftës, ndërsa përballet me kufizimet dhe gjuhën burokratike të raportimit të krizave për audienca të largëta.

Njihuni me Artistin:

Vepra të zgjedhura audio dhe sonore të Sarah Washington: *MORSONATA*, *City of Drizzle* dhe *1000 Like*

Ligjërata të Montazhe të dritës nga Orgest Azizi në 50-vjetorin e veprës *Disiplinë dhe Ndëshkim* të Michel Foucault. Ligjërata është në gjuhën shqipe.

Në dialog me Dine Dine për burgosjen për përhapjen e Teorive të Frojdit. Intervista është në gjuhën shqipe.

Zoonpoetikon & Anadil / Revista Mother Tongue

Përzgjedhje këngësh nga Kolektiv Radio për PRISON RADIO

E PREMTE 11.9.

→8.00

PRISON x LISTENING

Intervista / copëza audio-zanore kushtuar burgosjes dhe përvojave të burgosjes me Alban Beqiraj në dialog me Yassin al-Haj Saleh, shkrimtar dhe disident politik sirian. Intervista është në gjuhën angleze.

Eli Krasniqi në dialog me Hava Shalën mbi perspektivat gjinore të burgosjes. Intervista është në gjuhën shqipe.

Intervista të përzgjedhura me ish-të burgosur politikë nga arkivat e *Iniciativës së Historisë Gojore të Kosovës*: Hydajet Hyseni, Teuta Hadri, Hasan Dërmaku dhe Ibish Neziri. Intervistat janë në shqip.

Intervistë me Fatos Lubonjën mbi librin “Jetë burgu” dhe kujtimet nga burgu në Shqipëri. Intervista është në gjuhën shqipe.

→12.00

PRISON x LIVE RADIO

Lumpen Station (CH) drejtpërdrejt nga “Burgu i Idealit” me

PRISON x COMMUNITY

Sarah Washington (UK/DE), Knut Aufermann (DE) dhe pjesëmarrës nga masterklasa *Mobile Radio*

PRISON x LISTENING

Kolektiv Radio (KS), Sesione Dëgjimi & Muzikë

PRISON x EXERCISE

Uta Ibrahim (KS) dhe Eva Buzo (AU/

UK) në Community Run *Jam jashtë me fenerë, duke kërkuar veten*, disiplinën dhe trupin

PRISON x NOISE

Labinot Kelmendi (KS) mbi zhurmën si kategori shoqërore

PRISON x OPEN WATER

Eva Buzo (AU/MB) në bisedë me Ebi Spahiu (AL) mbi notin në distanca të largëta dhe ujëra të hapura

Performanca Speciale e 15-të live

PRISON x SURVEILLANCE

Maja Zeço (Bosnje dhe Hercegovinë/MB) Defend and Protect / Odbrana i Zaštita / Mbrotjtje dhe Ruajtje

Gjuhët që aplikohen gjatë transmetimeve të drejtpërdrejta do të jenë kryesisht anglishtja dhe shqipja, megjithatë, do të ketë edhe pjesë në gjuhë të tjera.

→16.00

PRISON x NOISE

Labinot Kelmendi (KS) *Zhurmhuri: Zhurma si pasqyrë e shoqërisë*. Kjo ligjëratë mbahet në gjuhën shqipe.

→18.00

PRISON RADIO x TRANSMISSION

CONCERT: Tonic Train feat. HAM Radio Orchestra Kosova (Sarah Washington (MB/DE), Knut Aufermann (DE), HAM Radio Association Kosova (KS)

PRISON x BURNING 1

Pas koncertit “Gvoon Versioni 1”: Instalacion sonor nga Holger Czukay i formuar nga kujtimet e Arthur Schmidt për burgos-

jen në burgjet e Stasit në RDGJ

→20.00 - 00.00

PRISON x NIGHTS

Kolektiv Radio (KS) Sesioni i Dëgjimit dhe Muzikës drejtpërdrejt nga Hani i dy Roberteve me një Seancë Improvizimi të Hapur

Lumpen Station (CH) Live from Hani i dy Robertëve

→00.00 - 8.00

PRISON x LISTENING

Tinguj të Dedikuar, Art Radiofonik, Lexime Poezish dhe Intervista mbi Burgosjen dhe Përvojat e Burgosjes me

Karim Ait-Gacem Radio Parloir: *Zëra nga Lantini me Burgun Amour*. Audio të përzgjedhura nga punëtorja e radios me të burgosurit e Burgut të Lantinit në Valoni, Belgjikë. Pjesa është në gjuhën frënge.

111 është një instalacion audio i artistit brazilian Nuno Ramos, që i përgjigjet masakrës së burgut Carandiru në São Paulo në vitin 1992, ku policia ushtarake vrau 111 të burgosur. Ky instalacion u krijua live si pjesë e përkujtimit të 20-vjetorit të masakrës. Muzikanti brazilian Max B.O. lexon emrat e 111 të burgosurve. Vepra është në portugalisht.

Njihuni me Artistin:

Vepra të zgjedhura audio dhe sonore të Adina Camhy: *KRST, Concert Post Covid Society, Grand Carry (Adina Camhy Remix) me Sanna Lu Una*, dhe *Wow* performuan në Signal Festival

Lista e kuruar nga Mina Mohseni
Këngët e Rezistencës nga Irani

Nderim Arifi *Malli i yjeve*. Koncert kitarë klasike në Ditën e të Zhdukurve, mbajtur më 30 gusht 2025 në Burgu i Idealit.

Lista e këngëve nga Festivali i 11-të i Këngës në Radio Televizionin Shqiptar në vitin 1972, një ngjarje që u pasua nga persekutimi dhe ndëshkimi i disa dhjetëra artistëve.

Leximi i veprës së Victor Hugo-s, *Dita e fundit e një të dënuari*, ndjek një të burgosur pa emër që pret ekzekutimin, duke regjistruar frikën, kujtimet dhe mendimet e tij që ndryshojnë ndërsa vdekja afrohet. Leximi është në gjuhën angleze.

MOS U SHQETËSO, DO TË JEM SLAVI
YT & نیچس

Përzgjedhje këngësh nga Kolektiv Radio për PRISON RADIO

E SHTUNË 12.9.

→8.00

PRISON x LISTENING

Intervista / copëza audio-zanore kushtuar burgosjes dhe përvojave të burgosjes me Nerimane Kamberi në dialog me Sébastien Gricourt-in rreth angazhimit të tij në Kryqin e Kuq Ndërkombëtar në Kosovë dhe vizitave të tij në burgjet tjera. Intervista është në gjuhën shqipe dhe frënge.

Intervista të përzgjedhura me ish-të burgosur nga arkivat e *Iniciativës së Historisë Gojore të Kosovës*: Berat Luzha, Zahrije Podrimqaku, Hava Shala dhe Shukrije Gashi. Intervistat janë në gjuhën shqipe.

Dialog me Pjeter Arbnorin mbi vitet e gjata të burgimit në Shqipëri. Intervista është në gjuhën shqipe.

→12.00

PRISON x RADIO LIVE

Lumpen Station (CH) drejtpërdrejt nga "Burgu i Idealit" me

PRISON x RESISTANCE

Eli Krasniqi (AT/KS) dhe pjesëmarrësit nga masterklasa *Arkiva në pezullim: Kohështrirjet e Lëvizjes së Rezistencës në Kosovë*

PRISON x SOLIDARTY

Adina Camhy (AT), instalacion sonor
Që të mos ndihemi kurrë vetëm

PRISON x VOICE

Sarah Washington (MB/DE), instalacion sonor *Different Light*

PRISON x HOPE

Thomas Krempke (CH) prezantohet me ekspozitën *E di që bëhet më i bukur...*

PRISON x FREEDOM

Hazir Reka (KS) me ekspozitën
Dalja nga Terri

PRISON x ART

Elsa Demo (AL) në dialog me Krenar Zejnon (AL) *Nga hiri i imazheve*

Performanca Speciale e 15-të Live

PRISON x FREKUENCA

Anouk Albrecht (DE)

Episodi 6, pjesë performative nomade në vijimësi

Gjuhët që aplikohen gjatë transmetimeve të drejtpërdrejta do të jenë kryesisht anglishtja dhe shqipja, megjithatë, do të ketë edhe pjesë në gjuhë të tjera.

→16.00

PRISON x LITERATURE

Elsa Demo (AL) Ese Live në Radio
Nga heshtja e fjalëve. Ligjërata mbahet në gjuhën shqipe.

→17.00

PRISON x GARDEN

Ligjërata nga Orgest Azizi (AL/FR) *Zëra të mbytur, bar i egër*. Ligjërata mbahet në gjuhën shqipe.

→18.00

PRISON x BODY

CONCERT: Adina Camhy (AT): Camhy ndërthur përvoja me Sindromën Post-

Covid, regjistrime nga terreni i ashpër karstik, improvizime të regjistruara në një organ druri kishe në një fshat malor alpin, dhe fragmente poemash që trajtojnë sëmundje kronike dhe shpresë

PRISON x BURNING 1

Pas koncertit "Gvoon – Versioni 2-11":
"Gvoon – Versioni 2-11" ftoi artistë ndërkombëtarë si Kim Gordon (Sonic Youth dhe Body/Head), Jochen Arbeit (Einstürzende Neubauten) dhe shumë të tjerë për të rishkruar materialin origjinal të Holger Czukay, *Brennung 1*

→20.00 - 00.00

PRISON x NIGHTS

Kolektiv Radio (KS) Sesioni i Dëgjimit dhe Muzikës drejtpërdrejt nga Hani i dy Roberteve me Toni Dimitrov (MKD) duke performuar *Listening mbrapsht* dhe Ygretmen (KS) Lumpen Station (CH) Live from Hani i Dy Robertëve

→00.00 - 8.00

PRISON x LISTENING

Tinguj të Dedikuar, Art Radiofonik, Lexime Poezish dhe Intervista mbi Burgosjen dhe Përvojat e Burgosjes me Karim Aït-Gacem Radio Parloir: Zëra nga Lantin me Jolie Matonne. Audio të përzgjedhura nga punëtorja e radios me të burgosurit nga Burgu Lantin në Valoni/Belgjikë. Pjesa është në frëngjisht.

111 është një instalacion sonor i artistit brazilian Nuno Ramos, që i përgjigjet masakrës së Burgut Carandiru në São Paulo në vitin 1992, ku policia ushtarake vrau 111 të burgosur. Ky instalacion u krijua si pjesë e përkujtimit të 20-vjetorit të masakrës. Artisti brazilian Nuno Ramos

lexon emrat e 111 të burgosurve. Vepra është në gjuhën portugeze.

Verena Walzl KAHN x PANTHER
Lexim i poezisë *Der Panther* nga Rainier-Maria Rilke në shumë gjuhë të botës, dhe me një interpretim nga Oliver Kahn.

Lista e kuruar nga Sarah Washington me Pere Ubu, Dr Alimantado, Tim Buckley, All About Eve, dhe shumë të tjerë.

Dialog me Nina Wetzel mbi kampet dhe teatrin. Intervista është në gjuhën angleze.

Leximi i Burgut të Emmy Hennings.
Romani trajton periudhën e burgimit të autores që zgjat rreth tre muaj përgjatë viteve 1914 dhe 1915. Leximi është në gjuhën angleze.

SABA SABA & Ufunet
Përzgjedhje këngësh nga Kolektiv Radio për PRISON RADIO

E DIEL 13.9.

→8.00

PRISON x LISTENING

Intervista / copëza audio-sonore kushtuar burgosjes dhe përvojave të burgosjes me

Elsa Demo në dialog me Kasëm Trebeshinën. Trebeshina ishte aktivist i Frontit Kombëtar të Çlirimit në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe më pas shërbeu si oficer ushtarak, aktor teatri dhe shkrimtar. Për shkak të kundërshtimit ndaj dogmave letrare të Realizmit Socialist u dënua disa herë me burgim e internime dhe vepra e tij u ndalua, duke mundur t'i botohej vetëm pas viteve '90 në Prishtinë. Kjo intervistë transmetohet për herë të parë si pjesë e PRISON RADIO. Intervista është në gjuhën shqipe.

Intervista të përzgjedhura me ish-të burgosur politikë nga arkivat e *Iniciativës së Historisë Gojore të Kosovës*: Rexhep Bunjaku, Afide Topalli dhe Meriman Braha. Intervistat janë në gjuhën shqipe.

→11.00

PRISON x LIVE RADIO

Lumpen Station (CH) drejtpërdrejt nga "Burgu i Idealit" me

PRISON x SCHOOL

Maja Zeço (BiH/MB), Blertë Ismajli (KS), Verena Walzl (AT) dhe pjesëmarrës të Sound Walk *Retracing Steps*

PRISON x PERCEPTION

Orgest Azizi (AL/FR) Diskutim mbi ligjëratën *Zëra të mbytur, bar i egër*

PRISON x POEZIA

Abdullah Rexhepi (KS) mbi poezinë e lashtë persiane dhe poezinë tradicionale persiane *habsiyyât/burg*

PRISON x PASIONI

Bisedë me Bajram Gashin, njohës i radios dhe audiofil

FJALËT PËRMBYLLËSE TË FESTIVALIT

Gjuhët e transmetimeve të drejtpërdrejta do të jenë kryesisht në anglisht dhe shqip, megjithatë, do të ketë edhe pjesë në gjuhë të tjera.

→13.00

PRISON x PRISON PERFORMANCA PËRMBYLLËSE E FESTIVALIT

PRISON x LISTENING

Knut Aufermann (DE)
Shëtitje dëgjimore e orientuar
mbetje e fara

MIRËNJOHJE:

Falenderime të përzemërta të gjithë artistëve, performuesve, muzikantëve, krijuesve radiofonikë, hulumtuesve dhe kontribuesve të tjerë, të cilët i besuan PRISON RADIO-s punën, zërat, njohuritë dhe kohën e tyre, dhe kontributet e të cilëve e mundësuan festivalin dhe e pasuruan atë.

FALENDERIME TË VEÇANTA PËR:

Hava Shala
Martin Çuni
Akile Dedinca Zhegrova
Abdullah Zhegrova

dhe të gjithë ish-të burgosurit politikë që ndanë me ne kujtimet, përvojat dhe historitë e tyre.

FALENDERIMET TONA MË TË PËRZEMËRTA PËR TË GJITHË PARTNERËT DHE BASHKËPUNËTORËT TANË:

Burgu i Idealit & Molla e Kuqe
Lumpen Station
Kolektiv Radio
Hani i dy Robertëve

MBËSHTETJA FINANCIARE:
Ambasada e Zvicrës në Kosovë
Ambasada Austriake në Prishtinë

EKIPI I PRISON RADIO:

Alban Beqiraj
Blertë Ismajli
Alexander Vojvoda
Verena Walz

Organized by: STR/LLI

Supported by:



Hani i 2 Robertëve

Financed by:



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra



Austrian
Embassy
Pristina



Partners:

LUMPESTATION



molla
le kuqe